UNË NUK JAM MBIKËQYRËS I FESË, AS PASQYRA E SAJ!

ÇFARË DUHET QË TË BËJMË NË MUAJIN REXHEB?

KJO ËSHTË VAJZA MUSLIMANEQË MBART PETKUN E SHAMISË!

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 21 - Nr. 2 (240), Shkurt, 2023

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Hixhabi në këndvështrimin social

Sigurisht për hir të së vërtetës duhet të pranojmë që rrugëtimi me raste mund të jetë vështirësuar, jo nga mbulesa në vetvete, por nga mendësia e njerëzve që ne rrethohemi përditë, ama arritjet më së shumti na kanë shijuar...

"RROBA E DEVOTSHMËRISË ËSHTË MË E MIRË!"

(f. 16)

NJË NATË E PAHARRUESHME NË ST. GALLEN, NË "EL-HIDAJE" TË VLERAVE TË BESIMIT

(f. 17)

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

NJË DATË, JO SI ÇDO DATË..!?

Padyshim, kjo datë, që na kthen shumë vite pas në kohë, duhet të mos ngelet thjeshtë një moment reflektimi, por duhet të shërbejë si një çast analize, për të parë veten në pasqyrë, për vemdosur në peshore të sotmen dhe për të mos lejuar përsëritjen e shkeljes...

Ca data, nuk duhen harruar! Jo për të ruajtur linjën emocionaliste të ndodhive, që për inerci të fakteve, na tërheq drejt zhargonit të turmës.

Porse, ca data, janë stacione të rëndësishme të zgjimit të ndërgjegjes dhe nxitjes për të jetuar si elitë, larg tërheqjes të jetuar jashtë natyrës, në të cilën na krijoi Krijuesi i gjithësisë!

Padyshim, kjo datë, që na kthen shumë vite pas në kohë, duhet të mos ngelet thjeshtë një moment reflektimi, por duhet të shërbejë si një çast analize, për të parë veten në pasqyrë, për vemdosur në peshore të sotmen dhe për të mos lejuar përsëritjen e shkeljes, siç shkelen insektet, që sot ofrohen edhe si ushqim plot proteina dhe kalori!

"Nën dritën e fjalimit tuej të 6 shkurtit, ju premtojmë se do të përqafojmë dhe do t'i vemë në jetë mësimet e partisë për zhdukjen e të gjitha mbeturinave, do të djegim me zjarr çfaqjet e hueja që pengojnë ecjen tonë përpara dhe do të kalitemi me moralin komunist.

Pak ditë ma parë ne vendosëm njëzani t'i kthejmë dy xhamijat e lagjes nga institucione të errësinës dhe vatra të propagandës së çfrenueme kundër interesave të popullit në qendra për edukimin dhe argëtimin e brezit të ri...

Tue kuptue damin që i sjellin familjes dhe shoqnisë zakonet prapanike dhe bindjet fetare, ne zotohemi:

1) Do të punojmë me të gjitha forcat si aktivistë të organizatës së frontit për të dërmue çdo gja që pengon, sado pak, ecjen tonë në rrugën e caktueme nga partia jonë e lavdishme.

2) Do të heqim të gjitha ceremonitë e festat fetare që kanë xanë vend deri tashti.

3) Nuk do të presim njeri për festat fetare. ..."

– [Letër e hapur e popullit të bllokut nr. 1-2 të lagjes "Kongresi i Përmetit", Shkodër, me titull: "Do të heqim të gjitha ceremonitë e festat fetare", në gazetën "Zëri i popullit", v. 26, nr. 73 (5798), e dielë, 26 mars 1967, fq. 3. (Letra mban datën 19 mars 1967)].

Shkodër, më 6 shkurt 2023

KY ISLAM ËSHTË FÉ UNIVERSALE, JO THIRRJE LOKALE A "PRONË E ARABËVE DHE TURQVE"..!

Ky Islam është fé universale, jo thirrje lokale a "pronë e arabëve dhe turqve", siç shprehet dikush në gjendje dehjeje intelektuale dhe ngarkese kompleksesh fetare të pajustifikuara!

Ky Islam është Drita e Zotit të Vërtetë, thirrja e Tij për të gjithë ne, përgjatë historisë së njerëzimit dhe dallgëve të saj!

Sado të goditet pas shpine, sado të gjuhet përballë, sado të paraqitet shëmtueshëm nëpërmjet artit të pamoralshëm e urrejtjes karikatureske të zemërmbyllurve, Islami ngelet garanci e përjtshme e Paqes, Tolerancës dhe Ekuilibrit, kudo në botë!

Nuk i imponohet askush dhe asgjë! Nuk vlen asnjë hile dhe asnjë përpjekje e dështuar për "ta zënë mat"!

Ne gabojmë, harrojmë e devijojmë, hutohemi dhe ngatërrojmë, na mund nefsi e, mund të humbim edhe fillin e udhëzimit e dritën e tij, por Islami mbetet Bardhësi, që s'ka njollë njeriu, kushdoqoftë ta hirtësojë a ta zizojë, kurrë!

> **"Ky Islam është Dritë, drita e këtij shekull! Drita, drejt së cilës, mendjet më të urta e intelektualët më të spikatur në botë, janë udhëzuar drejt tij! Kështu ndodh edhe sot! Kështu do të jetë përherë!"**

Ky Islam është Dritë, drita e këtij shekull! Drita, drejt së cilës, mendjet më të urta e intelektualët më të spikatur në botë, janë udhëzuar drejt tij! Kështu ndodh edhe sot! Kështu do të jetë përherë!

Dhe, siç thotë Shejkhul-Ez'heri, Imam Ahmed Et-Tajjib: "Unë jam musliman, që e dua krejt njerëzinë! Unë jam i shqetësuar për çështjet e paqes, me krejt këndvështrimet e saj fetare, shoqërore dhe botërore. Unë kërkoj për këtë paqe dhe ia dëshiroj krejt njerëzve, sado të ndryshme të jenë atdheu, racat dhe kombet e tyre, dhe sido që të jenë fetë dhe përkatësitë e tyre!

Allahu nuk i ka krijuar njerëzit që të vriten, të torturohen a të ngushtohen në jetesën e tyre. Allahu nuk ka nevojë që dikush të marrë shpirtra a të terrorizojë në emër të Tij!"

Dhe, siç na edukuan Mësuesit tanë dhe siç e përsëriste shpesh Edukatori ynë i madh, Shejkh Ahmed Keftaro: "Islami është feja e shekullit 21!"

10 VJET, QË KUR HOXHA I JONË, H. VEHBI SULEJMAN GAVOÇI KALOI NGA KJO BOTË...

Emri i Hoxhës vazhdon të përmendet përherë e më shumë, plot dinjitet e krenari, në një kohë krizash, dilemash e padrejtësishë; në kohët, kur imazhi i Prijësit është mjegulluar e, ku duar të shumta janë përzier për të devijuar rrugën, imazhin, mesazhin, duke e zëvendësuar portretin e Mësuesit tradicional me copëza të ngjitura portretesh artificiale, që s'formojnë dot një imazh..!?

Koha kalon, kujtimet ruajnë qetësinë e mallit, gjurmët e diturisë, të përhapura në faqe librash, vazhdojnë të rrezatojnë në çdo shfletim, duke ngritur në piedestalet e nderimit dhe të mirënjohjes, ditë pas dite e kohë pas kohe, imazhin e Dijetarit, Edukatorit, Mësuesit, Shembullit të udhëzuesit drejt moralit të fesë së tij dhe traditave të të parëve, kalorësit të mejdaneve të dijes e trashëgimisë së lidhur brez pas brez e të dalë nga gjokset e burrave besnikë; H. Vehbi Sulejman Gavoçi!

Nuri i shfaqjes së Hoxhës, ditë pas dite shkëlqen, si Diell që na ngroh, edhe pse shpeshherë, si pa dashje e harrojmë, a edhe e neglizhojmë praninë e tij; kujtohemi ta kërkojmë, vetëm kur bie shi, a kur qiellin e mbulojnë re ngjyrë gri.., ndonëse ai është përherë aty, si një bekim e mëshirë e Allahut për ne! Edhe pse drita e tij është përherë aty, tamam si atë ditë të parë të takimit tonë, e atë ditë të fundit të telefonatës, që u mbyll me bekimet dhe lutjet e tij prindërore!

Vitet kalojnë, por lidhja e zemrës nuk e ka humbur fillin, nuk e ka thyer besën, as e ka shkelur premtimin.., vazhdon me bindje e dashuri, durim e sakrificë të mbajë në shpirt torçën e amanetit, duke u përballur me lloj-lloj shfaqjesh e fenomenesh, përherë në besë e me lutje për t'a forcuar Zoti në çdo rrahje e frymë!

Vitet kalojnë, madhështia e pranisë së Edukatorit vazhdon të dëshmojë mirësinë e Allahut ndaj nesh, fatmirësinë e takimit, bukurinë e shkëndijës së parë të ndezur, që nga momenti i kontaktit të parë të syve dhe, pa dyshim, rrugëtimin me bindje në atë rrugë të vizatuar nga zemra e të Bardhit Hoxhë, këshillat e të cilit na mëkuan për të mos u dorëzuar në rrugëtimet ton të dijes dhe urtësisë..!

Emri i Hoxhës vazhdon të përmendet përherë e më shumë, plot dinjitet e krenari, në një kohë krizash, dilemash e padrejtësishë; në kohët, kur imazhi i Prijësit është mjegulluar e, ku duar të shumta janë përzier për të devijuar rrugën, imazhin, mesazhin, duke e zëvendësuar portretin e Mësuesit tradicional me copëza të ngjitura portretesh artificiale, që s'formojnë dot një imazh..!?

Bukuria jusufike e shfaqjes Tënde, i Shtrenjti Mësues, mbetet kible për zemrën, dritësim për çdo hap, udhëzim për mendjen e, mbi të gjitha borxh i shpirtit, deri në ditën e kijametit!

Rahmet të pastë Shpirti, i Dritshmi Hoxhë Vehbi Sulejman Gavoçi!

Si djalë, Muhamed B. Sytari.

19 shkurt...

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari:

"Pamjet e sensibilizimit të muslimanëve në mbarë botën me rastin e fundit të tërmeteve në Turki dhe Siri, janë dëshmia më e qartë se ky YMMET nuk bie kurrë dhe se VËLLAZËRIA ISLAME, është një ndjesi e shenjtë në genet tona, nuk e ç'bën dot as mëndafshi dhe as zjarri!

Elhamdulilah, që jemi dëshmitar të kësaj kohe dhe shenjave të pakthyeshme të RIZGJIMIT TË MADH, mbi gërmadhat e një hutimi që nuk do zgjaste deri në kiamet!"

Islami është feja e Zotit, dini i Allahut, paketa më e sigurt për udhëzimin e njeriut në jetë, ndërsa unë e ju jemi njerëz dhe, njeriu është i mangët, i gabueshëm!

UNË NUK JAM MBIKËQYRËS I FESË, AS PASQYRA E SAJ!

Nuk përkufizohet Islami në veprimet e mia, as në sjelljen time, as në dijen a preferencat e mia intelektuale! Nëse ndonjëherë keni kuptuar të kundërtën e saj në fjalët a shkrimet e mia, ju kërkoj shumë ndjesë!

Islami është feja e Zotit, dini i Allahut, paketa më e sigurt për udhëzimin e njeriut në jetë, ndërsa unë e ju jemi njerëz dhe, njeriu është i mangët, i gabueshëm!

Për këtë, tek ne në Islam, feja konsiderohet rregullator i jetës, ndërsa besimtari ftohet të jetë shembull i saj, pasqyrim i vërtetësive të saj në moral e sjellje, në mendime e ndjenja, në dituri e përparim dhe përtej tyre, duke u disiplinuar me rregullat e saj, duke respektuar vijëzimet e rrugës së gjatë...

Fakti që të dërguarit e Allahut ishin njerëz, pasqyron më së miri, se feja ka një rol të pazëvendësueshëm në edukimin dhe disiplinimin e jetës së njeriut, sipas hartës më të saktë të edukimit dhe udhëzimit të saj, që Zoti shpalli për njerëzimin, për të mos e lënë atë në dorë të egos dhe kapaciteteve të ngushta, në përmasat e të cilave, e krijoi!

Por, ndodh që njeriu, për një arsye a një tjetër, të humbasë ekuilibrin, të gabojë, të hutohet, të bëjë gjynah, të bie në batakun e egoizmit, mendjemadhësisë, vetëkënaqësisë e arrogancës. Në këtë rast, assesi nuk duhet marrë për bazë e t'i llogaritet fatura e lëkundjeve të tij, fesë!? Nëse reflekton dhe pendohet, Zoti e faltë dhe e mëshiroftë. Nëse jo, Zoti e shëroftë, se është i sëmurë rëndë! Ndërsa feja, feja mbetet qelibar, e paprekur, e papërlyer!

Feja qëndron mbi njeriun! Njeriu që disiplinohet me fenë dhe dëshmohet si "Kuran i gjallë", që lëviz mbi tokë, dëshmon mrekullinë e saj në jetën tonë. Por, as ky lloj njeriu, as ndonjë tjetër, kurrsesi nuk ka, as mund të ketë të drejtë ta konsiderojë veten si mbikëqyrës i fesë, i Thirrjes Islame, i institucioneve fetare e përtej tyre! Njeriu është kalimtar, feja jo, nuk vdes as shuhet me njërin a tjetrin, as shuhet me dhunimin, cënimin, shpifjen a trillimin, luftën a përpjekjet kundër saj!

Unë nuk jam mbikëqyrës i fesë, as pasqyra e saj! Kjo fé dhe kjo Thirrje qëndrojnë mbi mua dhe përtej meje! Unë fisnikërohem duke i shërbyer me sa të kem mundësi, forcë e jetë!

Ato bëjnë edhe pa mua, njësoj si çdo institucion ku mund të kem punuar, a aktualisht ku vazhdoj të shërbej! Kjo është një mesele, që vlen t'ia kujtojmë shpesh vetes, më së paku!

Allahume na bëj çelësa të së mirës, drynj të së keqes dhe na mbro nga intrigat e kësaj bote kalimtare dhe bataku i së keqes, injorancës, mediokritetit!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari

Shkodër, 7 shkurt 2023



Dr. Ajni Sinani

Kryetar i Kuvendit
të Bashkësisë islame të Kosovës

"

Au imponua feja islame?!

Në Kosovë 500 vjet Perandori Osmane ka kisha të vjetra qindra vjeçare!

Në Stamboll ka kisha qindra vjeçare.

Në Kajro, Damask, Bejrut etj, kisha mbi një mijë vjeçare, që nuk janë prekur fare. Janë që nga koha e shokëve të Pejgamberit. Aty ku ka xhami dhe minare afër tyre ka edhe kisha.

Shihni Kosovën. Vizitoni vendet muslimane!

Ku mbeten 200 xhami në Beograd?

Ku mbeten me qindra e mijëra xhami në Spanjë, Portugali e Greqi?!

Këto janë fakte e dëshmi të prekshme për secilin prej nesh.

Akoma me broçkulla të propagandës sllavo-greke?!

NË SKENËN E XHENAZES..!

Dr. Mustafa Mahmud

Në skenën e xhenazes më kaplon frika, që në momentin e mbylljes së varrit dhe njerëzit shpejtojnë për ta lënë vetëm të vdekurin e tyre.

Jashtë varrit, dikush qan... një tjetër hidhërohet... e dikujt tjetër, as që ia ndjen...

Në varr dikush thotë: Zoti im është Allahu; feja ime është Islami dhe profeti im është Muhammedi (a.s); dikush tjetër thotë: Ha,ha, ha, nuk e di!!

Nga jashtë ia mbyllin mirë varrin, sa nga njëra anë, sa nga ana tjetër, sikur ata frikësohen se mos del prej tij...

Në varr dikush thotë: O Zot, bëje kiametin; ndërsa dikush tjetër thërret: 'O Zot, më kthe, ndoshta punoj vepra të mirë, që kam lënë (pa bërë)!'.

Jashtë dikush ruhet prej dheut (se mos njollos rrobat), e rraskapit dielli i nxehtë apo moti i ftohtë, dhe mërzitet prej lutjes (duasë) së gjatë...

Në varr, asnjëri nuk zotëron, veçse dy metra në metrat e universit të gjerë, një copë qefin, punën e tij dhe lutjet (duatë) e të devotshmëve.

Jashtë, pa kaluar çerek ore, vendi boshatiset dhe aty mbretëron heshtja, e vizitorët largohen...

Në varr ka zhurmë... dikush gëzon dhe shikon vendin e tij në xhenet... e dikush tjetër çirret prej vendit të ngushtë dhe territ nga tmerri dhe frika.

> **"Për diçka të tillë, le të punojnë, ata që duan të punojnë!"**
> *(Kur'ani, Es-Safat: 61)*

Jashtë, disa njerëz kanë shkuar në shtëpi me kondicionerë, në xhami me kondicionerë, me makina me kondicionerë dhe nxitojnë të largohen nga të nxehtit apo nga të ftohtit...

Ndërsa në varr dëgjojnë krismat e këpucëve të atyre, që i kanë dashur, ndërkohë ata largohen, dikush në gjerësi, butësi dhe mëshirë, dhe dikush tjetër në ngushtësi, nxehtësi dhe vështirësi.

A në mirësi jetojmë, apo në ndëshkim dëshpërojmë...

"Për diçka të tillë, le të punojnë, ata që duan të punojnë!" – (Kur'ani, Es-Safat: 61)

Nuk ka shpëtim prej vdekjes!

O Zoti ynë, ne kemi të meta, na i fal ato, o Zot!

O Zoti ynë, sillu ndaj nesh me faljen Tënde, me mëshirën, me bujarinë dhe mirësinë Tënde!

O Zoti ynë, kërkojmë nga Ty, përfundim të mirë!

Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja



Dr. Selman El-Aude

"

Ashtu siç lanë disa herë çdo ditë fytyrën dhe duart tuaja me ujë, sepse ti me to takon njerëzit, ashtu duhet të lashë edhe zemrën, të cilën ta sheh Allahun i Lartmadhëruar.

Laje këtë zemër dhe çdo ditë premto se në të nuk do të depozitosh mllefe, urrejtje, smirë dhe kujtime të hidhura, të cilat janë pranga, që të pengojnë të lëvizësh, të ecësh, të punosh dhe që të ndalojnë të kënaqesh në jetën tënde!

KJO ËSHTË VAJZA MUSLIMANE QË MBART PETKUN E SHAMISË!

*Nga kjo përvojë më vjen një mesazh
për të gjithë vajzat e gratë që mbartin apo duan
të vendosin shaminë qartësoni qëllimin
dhe brendësoni arsyen pse Zoti na ka bëre dispozitë hixhabin.*

Brixhida Muça
Teologe - Tiranë

Ishte viti 1994 kur për herë të parë në Tiranë, ecnim bashkë në rrugë, 5 vajzat e para të mbuluara me shami, të kthyera për pushimet e studimeve.

Habia çudia e mendësia bashkohej me paditurinë fetare.

Kishte kërcënime, mungesë lirie për të dalë lirshëm në rrugë, presioni nga familjet, fisit, miqtë e shoqërisa, se ne po ndjekim injorancën e jo zhvillimin, pavarësisht se po studionim degën me zgjedhjen tonë të lirë në universitet.

Nuk u tunduam të kthehemi mbrapsht nga bindja jonë, ishim gati me një guxim rinor të përballeshim me të gjitha kundërshtitë e kërcënimet.

Po çka i bënte të vendosura vallë mendjet e zemrat tona rinore!? Formimi ynë për të qenë vetvetja, të pa diktuara nga opinioni. Vetëdija se rruga që kishim zgjedhur është ajo çka donim dhe na përmbushte shpirtërisht.

Ishim të ndërgjegjshme se ky vendim kishte sfida dhe ne s'do dorëzoheshim sado pengesa e paragjykime të hasnim nga opinioni.

Dhe jeta tregoi se vendimi i marrë për të vënë hixhabin, si dhe për të studiuar për fé, nuk u lëkund asnjë moment përgjatë 31 vitesh.

Kjo vërteton se devotshmëria që i përkushtohemi një vendimi në jetë të mbush me vetëbesim në atë vendim të marrë duke të bëre të palëkundur.

Ajo çka, dua të them është se u përballëm me fjalë fyese, paragjykuese, lënduese, kërcënuese, na afruan vende pune me pozicione lakmuese veç të hiqnim shaminë, por JO asgjë s'na tundoi të ndryshonim vendimin tonë.

Ne ishim të bindura se, Zoti do na jepte sukses nëse ne do ishim të forta në besim, në vendimet tona dhe duke u aftësuar në dije.

Dhe vërtet ashtu ndodhi dhe jeta e tregoi!

Nga kjo përvojë më vjen një mesazh për të gjitha vajzat e gratë që mbartin apo duan të vendosin shaminë; qartësoni qëllimin dhe brendësoni arsyen pse Zoti na ka bërë dispozitë hixhabin. Ajo që do t'ju bëjë të palëkundura është nëse do të fitoni lirinë nga varësia e opinionit dhe dëshirat shfrenuese qe ju afrohen në këtë jete, ku njeriu ka humbur rëndësinë reale.

Mos u merrni se çfarë thonë, e me termin *"diskriminim"*, por paraqituni kudo me vetëbesim, aftësi e vlera se do të merrni atë qe meritoni. Kujdes! Mos harroni se nëse diku nuk ju pranojnë, kjo do të thotë që nuk është caktim për ju. Ne e dimë kur Zoti e cakton një gjë për ne, atë s'ka gjë që e ndalon. Pra, mos u merrni me terma që shërbejnë veç për fonde e jo zgjidhje, sepse zgjidhja je vetë ti me etikën, aftësinë, e vetëbesimin për atë ç'ka je, e synimin që ke.

Ji vetvetja.

Arritjet në aftësim të mbushura me vetëbesim, do të të bëjnë të mos ndjesh diskriminim.

E bindur në zgjedhje dhe e pa lëkundur në vendim në paqe me çdo caktim.

Kjo është vajza muslimane që mbart petkun e shamisë!

> **Ajo që do t'ju bëjë të palëkundura është nëse do të fitoni lirinë nga varësia e opinionit dhe dëshirat shfrenuese qe ju afrohen në këtë jete, ku njeriu ka humbur rëndësinë reale.**

HIXHABI NË KËNDVËSHTRIMIN SOCIAL

Sigurisht për hir të së vërtetës duhet të pranojmë që rrugëtimi me raste mund të jetë vështirësuar, jo nga mbulesa në vetvete, por nga mendësia e njerëzve që ne rrethohemi përditë, ama arritjet më së shumti na kanë shijuar, pikërisht nga tatëpjetat që arritëm të ngjisnim, për të shpërfaqur në fund ato mirësi me të cilat Allahu na zbukuroi jetën.

Msc. Arjeta Pelinku, *sociologe*

Hixhabi - mbulesa Islame është ndjesi, shpirtërore, dashuri dhe dëshirë për t'u afruar më shumë me Krijuesin përmes zbatimit të urdhrit të Tij hyjnor.

Allahu është tek ne ashtu sikurse ne e njohim, e ndjejmë, e besojmë Atë... E, në momentin që ndodh vendimi për të zbatuar këtë urdhëresë tek secila prej nesh, ka ndjesi unike që nganjëherë janë të vështira për t'u përshkruar me fjalë.

Nga ana sociale, ajo që na lidhet shpesh në momentin e vendosjes së hixhabit ka të bëjë me:

- Shkollimin
- Punësimin
- dhe krijimin e familjes, (fejesa e martesa)

Mitet e krijuara lidhen më së shumti me këto tre elemente. Pra, nëse do mund të zgjedhim shkollën që duam, nëse do arrijmë të finalizojmë arritjet tona përmes një pune e karriere, ashtu si ne dëshirojmë dhe nëse do gjejmë një bashkëshort, i cili të na pranojë ne së bashku me këtë mbulesën që ne vendosëm të zgjidhnim.

E çfarë ndodh me gjithë këtë frikë, pikëpyetje dhe presion mendor, që vjen si pasojë e vendimit tonë?

Ne kuptojmë stadin psiko-social të shoqërisë sonë, dëshirën tonë të madhe për të kënaqur Krijuesin përmes zbatimit të urdhëresës, ndërkohë që situata të vendos përballë familjes së vogël e të madhe, miqve dhe vetes tënde.

Ti në këtë moment sheh sa e përgatitur je për t'i dalë për zot hixhabit tënd, që në fund të ditës s'ka nevojë që ne ta mbrojmë, ta justifikojmë, të punojmë aq fort për të na pranuar me të, sepse është urdhëruar, kështilluar dhe mbrojtur që në krye të herës nga vetë Krijuesi.

Përtej filozofisë, përmes punës së madhe të motrave, nënave, vajzave ndër vite arritëm të tregojmë, që mbulesa nuk na mbulon mendjen, nuk na pengon arritjet. Sigurisht për hir të së vërtetës duhet të pranojmë që rrugëtimi me raste mund të jetë vështirësuar, jo nga mbulesa në vetvete, por nga mendësia e njerëzve që ne rrethohemi përditë, ama arritjet më së shumti na kanë shijuar, pikërisht nga tatëpjetat që arritëm të ngjisnim, për të shpërfaqur në fund ato mirësi me të cilat Allahu na zbukuroi jetën.

Përmes punës e përpjekjeve të vazhduara vijojmë akoma sot të tregojmë, që ne mundemi dhe ia dalim çdo ditë të zgjedhim shkollën që duam, të pajisemi me dituri të çmuar, të gjejmë punët e shumëpërfolura, por mbi të gjitha të jenë sipas rregullave tona për hallallin, e më e rëndësishmja të arrijmë të bëjmë zgjedhjen më të çmuar, atë të një bashkëshorti të denjë për krijimin e pasardhësve të devotshëm...

E vijon përpjekja dhe arritja jonë të flasë për ne dhe vepra jonë të na përfaqësojë ndërkohë që hixhabi - petku i devotshmërisë, qëndron mbi kraharorët tonë, për të na përkujtuar çdo ditë rëndësinë e misionit që zgjodhëm dhe ëmbëlsinë e imanit fillestar. Por na duhet punë e vazhdueshme për ta ujitur e për ta shikuar të lulëzojë me gjitha ngjyrat që zbukurojnë tablotë e pikturuara me aq përulësi, vërtetësi, këmbëngulje, dashuri e mirënjohje ndaj Atij, i Cili na zgjodhi të mbartim misionin dhe urdhëresën më të bukur islame, hixhabin – përmes së cilit da'veti (thirrja) jonë bëhet pa fjalë.

Është pikërisht ky petk devotshmërie, që së pari na shërben të vetëdijesohemi për dashurinë e madhe e të çmuar të Krijuesit ndaj nesh, duke na treguar se ne ishim të përzgjedhurat, njëkohësisht duke ardhur së bashku me të dhe përgjegjësia e prezantimit sa më të denjë, që i shkon përshtat një besimtareje të denjë të besimit islam, në gjitha kuptimet që kjo përfshin.

Ky, vendimi ynë, për të vendosur mbi kokat e kraharorët tanë, petkun e devotshmërisë,nuk na pengon lirinë, por na jep ne lirinë e vërtetë e të mirëfilltë të bërit të zgjedhjeve të frymëzuara tashmë nga mendimi, që udhëheq drejt besimit tek Allahu, Një i vetëm, i Cili as ka lindur kënd, as është i lindur dhe Atij askush s'i është i barabartë.

Dhe kjo zgjedhje e jona e lirë bëhet pikërisht për të arritur kënaqësinë e Tij me gjithë të drejtat dhe përgjegjësitë që kjo sjell nga pas.

ÇFARË DUHET QË TË BËJMË NË MUAJIN REXHEB?

Naim Drijaj
Imam - Xhamia Parrucë

Muaji Rexheb është muaji i shtatë sipas kalendarit hixhri dhe është një nga katër muajt e shenjtë. Allahu i Madhëruar i ka bërë të shenjtë disa muaj dhe i ka ngritur lart pozitat e tyre. Në to ndalohet që njeriu t'i bëjë padrejtësi vetes: "Vërtet, numri i muajve tek Allahu është dymbëdhjetë,[1] sipas Librit të Allahut, që prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Katër prej tyre janë të shenjtë, sipas besimit të drejtë...[2].

(Emrat e këtyre katër muajve të shenjtë nuk janë përmendur në Kuranin Famëlartë por janë përmendur në hadithet e Profetit (a.s). Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Viti ka dymbëdhjetë muaj. Katër prej tyre janë të shenjtë, Muharrem, Rexheb, Dhul-kade dhe Dhul-hixhe.[3]

PSE JANË EMËRTUAR TË SHENJTË KËTO MUAJ?

Janë quajtur muajt e shenjtë të tillë pasi në to ndalohet lufta dhe kjo ka qenë e njohur kështu edhe në periudhën para-islame të injorancës (xhahilije). Po ashtu dijetarët thonë se shkaku i shpalljes së këtyre katër muajve të shenjtë tek arabët ka ardhur për t'u dhënë mundësinë njerëzve të kryejnë Haxhin dhe Umren. Si rrjedhojë u bënë të shenjtë muajt Dhul-hixhe pasi Haxhi rastisi në të dhe bashkë me të edhe Dhul-kade me qëllim që njerëzit të udhëtojnë për të bërë Haxhin.

Po ashtu edhe Muharremi që njerëzit të kenë mundësi të kthehen dhe të shkojnë e të vijnë. Për muajin Rexheb thuhet se u shpall i shenjtë pasi njerëzit kryenin Umren në të në mes të vitit, ata që ishin rreth Mekes.[4]

Transmetohet nga Ali ibn Ebi Talha dhe Ibn Abasi (r.anhuma) se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu i Madhëruar ka veçuar katër muaj dhe i ka bërë të shenjtë. Ai e ka vlerësuar shenjtërinë e tyre dhe ka bërë që gjynahet të jenë më të mëdha dhe veprat e mira ta kenë shpërblimin më të madh."[5]

ÇFARË DUHET QË TË BËJMË NË MUAJIN REXHEB?

1. Në këtë muaj duhet të kemi kujdes maksimal për të ruajtur gjuhën, shikimin dhe veprat tona. Allahu (xh.sh) thotë: "Mos i bëni padrejtësi vetes në këto muaj"...[6] Padrejtësia ndaj vetes mund të bëhet në dy mënyra:

- Padrejtësi duke bërë gjynahe.

- Padrejtësi duke mos i kryer veprat e detyrueshme.

Allahu i Madhëruar na ka ndaluar nga zullumi (padrejtësia) gjatë këtyre muajve edhe pse ndalesa nga padrejtësia vlen për çdo muaj të vitit.

> **"Veprat e mira kanë më shumë shpërblim në muajt e shenjtë, kurse zullumi në to është më i madh se ai që bëhet në muajt tjerë, edhe pse zullumi në çdo kohë është gjynah i madh."**

Mirëpo gjynahet dhe padrejtësitë gjatë kësaj periudhe peshojnë më shumë sesa gjynahet dhe padrejtësitë gjatë muajve të tjerë. Zullumi i përmendur në këtë ajet përfshin çdo lloj të tij, nga zullumi më i madh, që është shirku në Allahun, deri në padrejtësinë më të vogël të njeriut, qoftë ajo mes tij dhe vetes së tij, apo mes tij dhe krijesave tjera të Allahut. Katade (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "Veprat e mira kanë më shumë shpërblim në muajt e shenjtë, kurse zullumi në to është më i madh se ai që bëhet në muajt tjerë, edhe pse zullumi në çdo kohë është gjynah i madh".[7]

2. Të përgatitemi për muajin e Ramazanit. Ramazani është një mundësi e mirë për të fituar shpërblimin, faljen dhe xhenetin e Allahut.

Nga ky muaj duhet që të bëjmë një plan me qëllim që ta kemi më të lehtë muajin e Ramazanit.

Të agjërojmë ditën e hënë dhe të enjte. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Veprat paraqiten tek Allahu ditën e hënë dhe ditën e enjte, unë dua që kur veprat e mia të paraqiten tek Allahu të jem agjërueshëm".[8]

Të lexojmë Kuran

Të falim namaz nate

Të urdhërojmë për të mirë dhe të ndalojmë nga e keqja... etj.

Ebu Bekër El-Belhi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "Muaji Rexheb është muaji i mbjelljes, muaji Shaban është muaji i ujitjes së të mbjellurave, kurse muaji i Ramazanit është muaji i të korrurave". Po ashtu ka thënë: "Muaji Rexheb i përngjan erës, muaji Shaban i përngjan resë ndërsa muaji Ramazan i përngjan shiut".[9]

3. Të pendohemi nga gjynahet. Besimtari duhet të nxitojë dhe të shpejtojë për të kërkuar falje tek Allahu (xh.sh). Allahu i Lartësuar thotë:"Kush bën ndonjë të keqe ose e ngarkon veten me padrejtësi, pastaj kërkon falje tek Allahu, do ta gjejë Allahun Falës e Mëshirëplotë."[10] Nëse gjynahet janë padrejtësi, pendimi është mjet me të cilin e largojmë dënimin.

Muaji i Ramazanit është një mundësi që besimtari të hapë një faqe të re me Allahun e Madhëruar. Ramazani është muaji i një gare jetësore për besimtarin. Suksesi i kësaj gare është falja e gjynaheve. Për ta arritur këtë duhet:

Përgatitje.

Mund.

Kujdes.

Pendim të vazhdueshëm.

1.Kalendari Hixhri ka 12 muaj me nga 29 ose 30 ditë.
2. Kurani, Et-Teube: 36.
3. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
4. Letaiful-Mearif, f. 115.
5. Ibn Ebi Hatimi tek "Et-Tefsiri", 6/1791, Bejhakiutek "Esh-Shuab", 5/340, me nr. 3525.
6. Kurani, Et-Teube: 36.
7. Tefsir Et-Taberij, 14/238;Tefsir Ibn Kethiri, 4/148.
8. Sahihu Tergib, 1041.
9. Letaif El-Mearif, Ibn Rexheb, f. 121.
10. Kurani, En-Nisa: 110.

XHELAL ZAGANJORI - SHKRIMTARI I VARFËR POR ME DINJITET, QË SHËTISTE RRUGËVE PËR TË MBIJETUAR NGA SHITJA E LIBRAVE...

Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Unda këto ditë në moshën 85-vjeçare Shkrimtari për fëmijë Xhelal Zaganjori (16.12.1938 - 25.02.2023)-

Me shkrimtarin Xhelal Zaganjori kisha një miqësi prej më se 50 vitesh. Një miqësi e bukur, plot virtyte e dhimbje pafund... Një njeri që në vite e kanë munduar sëmundjet dhe puna e rëndë në gatrrën e Kombinatit të Drurit. Edhe pse shëndetlig, edhe pse me duart të plasaritura e të enjtura shpesh rëndë, Xhelali nuk e lëshoi pendën apo stilolapsin nga dora... Shkruante herë pas here artikuj e kronika në gazetën "Jeta e re" të Shkodrës, si dhe përralla e tregime për fëmijë. Kështu vazhdoi jeta e tij duke shkruar për fëmijë... deri më 25.02.2023, kur ndërroi jetë në moshën 85-vjeçare, duke na lënë si pasuri zemre afro 20 libra për fëmijë e shumë shkrime gazetareske. Fëmijët shkodranë humbën një shkrimtar të dashur e të vlefshëm.

Xhelali u lind më 16 dhjetor të vitit 1938 në qytetin e Shkodrës. Pasi mbaroi 7-vjeçaren punoi punëtor në ndërmarrje të ndryshme të qytetit, ndërkohë që ndiqte dhe arsimin e mesëm duke marrë edhe maturën.

Po përmend disa vepra të Xhelalit, si: "Kapja e pilotit" (tregime, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1974), "Me babagjyshin te dielli" (tregime, Sh. B. "Camaj-Pipa", Shkodër, 1999), "Flamur gjaku mbi dëborë" (tregime, Sh. B. "Camaj-Pipa", Shkodër, 2001), "Premtimi (tregim i ilustruar, Sh. B. "Camaj-Pipa, Shkodër, 2003), "Dëshira e Artanit" (tregim i ilustruar, Sh. B. "Camaj-Pipa, Shkodër, 2004), "Motër e vëlla" (tregime, Sh. B. "Camaj-Pipa, Shkodër, 2008), etj. . Kam qenë i pranishëm në çdo botim të librit të tij, botim, teksa e shihte i gëzohej dhe e bënte të lumturohej si fëmijë. E prekte herë pas here librin e sapobotuar, e përkëdhelte, qante dhe e puthte. Xhelalit i qeshnin sytë e plakur, kur shikonte kopertinat dhe ilustrimet të bëra me kujdes e dashuri nga piktori i talentuar Gjergj Spathari. Si me zë, si në heshtje, si afër apo larg, ai orë e çast i çonte urime ilustratorit që ia kishte bërë librat me vlera e dinjitet.

Duke e njohur krijimtarinë e Xhelalit, ai kishte disa karakteristika që rrezatonin nga një libër në tjetrin, si: - u jepte rëndësi fabulave, - dinte të thurte kërkesat pedagogjike me ato letrare, - i befasonte të vegjëlit me të papriturat që u ndodhnin personazheve fëmijë, shpendë, kafshë, etj., dhe, nëpërmjet tyre përcillte mësime të virtytshme me vlera të mëdha për fëmijët, - skicat, tregimet dhe përrallat jo vetëm rrëfehen bukur por dhe i përshkonte tej e mbanë ato krijime të frymëzuara një fantazi e bukur e magjiplote, etj.

Shkrimtari Xhelal Zaganjori me talentin e tij, me letërsinë e bukur që na dhuroi zuri vend meritueshëm në panteonin e Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj.

E kush nuk e ka njohur Xhelalin në qytetin tim? Ndoshta është nga të rrallët shkrimtarë që ka udhëtuar me orë të tëra paradite e pasdite rrugëve pafund të qytetit të vendlindjes, që për të zvogëluar urinë dhe varfërinë shiste librat e tij që rrinin fshehur në çantën e tij si arkivë. Xhelalin e njohu çdo dyqan, çdo prind, çdo gjysh e gjyshe, çdo kafene, shumë biznesmenë, shumë mësues, shumë fëmijë, shumë...

Udhëtonte, ashtu në heshtje, shpesh kokëulur, rënë në mendime, me një ecje të ngadaltë pa trazuar askënd. Ishte ky njeri që shiste libra, ku një pjesë të parave i ruante për të ngrënë, një pjesë tjetër për blerë një libër të ri, një pjesë për të larë borxhet e Shtëpisë botuese, një pjesë tjetër, ashtu varfërisht për të pirë një kafe, shpesh herë i vetmuar, ku e zinte përvëlimi i diellit, shiu shkodran apo lodhja e madhe. E pas këtij pushimi të jetëshkurtër, teksa dialogonte me kafenë me shumë sheqer, Xhelali nisej përsëri për udhë... Hapa të tjerë, lodhje dhe shitje e ndonjë libri e prisnin... Në të shumtën e rasteve kthehej në shtëpi në të rënë të muzgut.

Xhelali u largua si pa u vënë re, edhe pse disa shkrime të pakta folën për të. Të vetmit që heshtën ishin institucionet që duhet ta thonin një fjalë, të paktën një fjalë. Tani është tepër vonë. Ai mori udhëtimit drejt qiellit.

Xhelali u largua, ashtu në heshtje, nga kjo jetë përqafuar dashamirësisht nga njerëzit e kujdesshëm e humanë të Institucionit të Azilit në Shkodër, ku jetonte prej disa kohësh.

Xhelali u largua i njohur nga të gjithë ne, për të hyrë përjetësisht në kujtesën e qytetit të tij të lindjes që e donte aq fort, ashtu thjeshtë, pa pretendime por me një bibliotekë librash. Një fat të tillë fisnik nuk e ka kushdo. Shkrimtari Xhelal Zaganjori me talentin e tij, me letërsinë e bukur që na dhuroi zuri vend meritueshëm në panteonin e Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj.

Shkodër, më, 27.02.2023

"Vullneti i Allahut! Atë që do, Ai e bën!
Ne nuk mund t'i kthejmë ata, të cilët humbën, por unë dua t'i qetësoj ata, të cilët humbën shtëpitë e tyre.
Ata nuk do të paguajnë asnjë lirë për të ndërtuar shtëpitë e tyre,
ne do t'u ndërtojmë atyre shtëpi dhe banesa më të mira, se ato që humbën.
Secili njeri, që ka humbur, qoftë edhe një pemë, do t'i kompensohet dhe dhjetë prej tyre!"

Recep Tayyip Erdoğan, President i Türkiyes

TËRMETI NË SIRI DHE TURKI - 6 SHKURT 2023

Ditën e hënë në mëngjes herë, më 6 shkurt 2023, një tërmet i rëndë goditi Sirinë, Türkiyen, dhe rajonin përreth pas, duke lënë me qindra të vdekur, mijëra të plagosur dhe dëme të shumta materiale.

Autoritet shtetërore në Türkiye në vazhdimësi janë duke bërë përpjekje për largimin e rrënojave dhe gjetjen e të mbijetuarve.

Një situatë e ngjashme, madje edhe më e rëndë, për shkak të pamundësive, mbizotëron edhe në Siri. Në pjesën veriore të saj, në rajonin të cilën nuk e kontrollon regjimi, aktivistët e Helmetave të Bardha kanë filluar aksionet e kërkim-shpëtimit.

Të mbijetuarit e tërmetit sirianë kalojnë një natë në xhaminë Aishe pas tërmeteve me magnitudë 7,7 dhe 7,6 ballë me qendër në Kahramanmaraş të Türkiyes, në lagjen Salkin të Idlibet, Siri.

Si pasojë e tërmetit, të paktën 3.162 persona humbën jetën në pjesë të ndryshme të Sirisë, më shumë se 5.235 persona u lënduan.

Për shkak të tërmeteve të ndodhura në Turkiye më 6 shkurt 2023, është shpallur zi kombëtare për një periudhë shtatëditore.

Djetëra mijëra pjesëtarë të njësiteve të kërkim-shpëtimit, punonjës mjekësorë dhe vullnetarë janë angazhuar në Türkiye për të ndihmuar të mbijetuarit nga tërmeti. Janë angazhuar avionë,

helikopterë, dronë, anije, eskavatorë dhe ambulanca.

Ekipet e kërkim-shpëtimit nga vendet e rajonit vazhdojnë të ndihmojnë në gjetjen e të mbijetuarve nën rrënojat pas tërmeteve të 6 shkurtit në Türkiye.

Ekipe nga Shqipëria, Kosova, Bosnjë e Hercegovina, Maqedonia e Veriut,

Serbia dhe Mali i Zi, të përbëra nga pjesëtarë të ushtrisë, specialistë të kërkim-shpëtimit, mjekë, qen gjurmues dhe pajisje të tjera janë nisur menjëherë drejt zonave të prekura nga tërmeti. Disa prej shteteve kanë dërguar edhe ekipe shtesë.

Tashmë dhjetëra të mbijetuar u shpëtuan nga ekipet e vendeve të

Ballkanit Perëndimor.

Ndryshe, specialistë të kërkim-shpëtimit kanë zbarkuar nga dhjetëra shtete nga e gjithë bota në Türkiye, ndërsa, përveç ekipeve zyrtare, po marrin pjesë edhe qindra vullnetarë.

Tërmetet binjake të Türkiyes me magnitudë 7.7 dhe 7.6 në Kahramanmaraş, ku humbën jetën më

شumë se 43,000 njerëz, lëvizën tokën përreth deri në 7 metra në drejtime të kundërta dhe shkaktuan një çarje 400 km të gjatë në sipërfaqen e tokës.

(Marrë nga: TRT)

FALËNDERIM DHE MIRËNJOHJE

Myftinia Shkodër shpreh falënderim dhe mirënjohje të thellë për të gjithë, ata të cilët ju bashkuan thirrjes për ndihmë dhe mbështetje ndaj vëllezërve dhe motrave turq dhe sirianë, që u lënduan nga tërmetet e 6 shkurtit 2023.

Në këtë fushatë mbështetëse vëllazërore janë grumbulluar rreth 20 mijë euro donacione, rroba dhe materiale të tjera të nevojshme, të cilat iu dërguan Myftinisë së qytetit të Iskenderunit, me të cilën Myftinia Shkodër ka binjakëzim.

Allahu i Madhëruar jua shpërbleftë të gjithëve me të mira në dynja dhe në ahiret, dhe jua shtoftë mirësinë e begatinë në familjet tuaja.

INDONEZIA, OSE REPUBLIKA E INDONEZISË

Indonezia, ose zyrtarisht Republika e Indonezisë, është një vend që ndodhet pranë brigjeve juglindore të kontinentit të Azisë, dhe shtrihet në oqeanin Indian dhe atë Paqësor. Ajo përbëhet nga mbi 17.000 ishuj, përfshirë ishujt Sumatra, Xhava, Sulawesi, dhe pjesë të Borneos dhe Guinesë së Re.

Indonezia ndan kufij me Malajzinë në ishullin Borneo, me Papua Guinenë e Re në ishullin Papua, dhe me Timorin Lindor në ishullin Timor. Vende të tjera fqinje të saj janë Singapori, Filipinet, Australia dhe territori i bashkimit të Ishujve Andaman dhe Nicobar në Indi.

Indonezia ka një sipërfaqe prej 1.904.569 km2, dhe një popullsi prej 281.184.912 banorësh (sipas worldometers.info; Shkurt 2023). Indonezia është shteti më i madh arkipelag në botë, vendi i 14-të më i madh për nga sipërfaqja, vendi i katërt më i populluar në botë (pas Kinës, Indisë dhe Shteteve të Bashkuara), dhe vendi me popullsinë më të madhe myslimane në botë. Xhava, ishulli më i populluar në botë, është vendbanimi i më shumë se gjysmës së popullsisë së vendit.

Xhakarta është kryeqyteti i vendit.

GJEOGRAFIA

Indonezia, arkipelagu më i madh në botë, ndodhet mes kontinentit të Azisë dhe Australisë, dhe shtrihet në dy oqeane, në oqeanin Indian dhe atë Paqësor. Indonezia përbëhet nga afërsisht 17.504 ishuj, ku 6000 prej tyre janë të populluar.

Pesë ishujt kryesorë në Indonezi janë Sumatra, Xhava, Borneo (i njohur në Indonezi si Kalimantan), Sulawesi dhe Guinea e Re. Atje gjenden dy arkipelagë të mëdhenj, Nusatenggara dhe Ishujt Maluku, si dhe 60 arkipelagë më të vegjël. Katër nga ishujt e Indonezisë ndahen edhe me vende të tjera. Ato janë: Borneo që ndahet me Malajzinë dhe Brunein, Sebatik ndahet me Malajzinë, Timori ndahet me Timorin Lindor dhe Guinea e Re që ndahet me Papua Guinea e Re.

Duke pasur kaq shumë ishuj, nuk është për t'u habitur që nëpër të gjithë Indonezinë të hasen veçori të shumta dhe të larmishme gjeografike. Në Xhava dhe Bali gjenden tokat pjellore të orizit. Në Sumatra, Kalimantan dhe Sulawesi, gjenden pyje tropikale, kurse në ishujt Nusatenggara gjenden kullota të savanës. Disa nga ishujt më të mëdhenj si Sumatra dhe Xhava kanë vargje të mëdha malore. Ishujt e Indonezisë janë të vendosur në dy brigje kontinentale, duke rezultuar që shumë male të tyre të jenë vullkanike. Për shembull, në Xhava gjenden pesëdhjetë vullkane aktive.

KLIMA

Duke qenë një vend tropikal, Indonezia ka një klimë pothuajse tërësisht tropikale, ku ka vetëm dy stinë: stinën me shi dhe stinën reshjet. Lagështia relative e zonës varion mes 70% dhe 90%. Megjithëse temperatura e ajrit ndryshon pak nga stina në stinë, ose nga një rajon në tjetrin, megjithatë, në lartësi më të mëdha mbizotërojnë temperatura më të ftohta. Në përgjithësi, temperaturat bien afërsisht në 1ºC, për çdo 90 metra rritje të lartësisë nga niveli i detit. Disa rajone malore të brendshme, me lartësi të mëdha, përjetojnë ngrica gjatë natës.

EKONOMIA

Si i vetmi shtet anëtar i G20 në Azinë Juglindore, Indonezia ka ekonominë më

e thatë. Pavarësisht ndryshime të konsiderueshme rajonale, në pjesën më të madhe të vendit (përfshirë Xhava dhe Bali) sezoni i thatë është nga prilli deri në tetor, ndërsa sezoni i lagësht me shi është nga nëntori në mars.

Ujërat uniformisht të ngrohtë që përbëjnë 81% të zonës së Indonezisë sigurojnë që temperaturat në tokë të mbeten mjaft konstante. Në fushat bregdetare temperatura mesatare shkon në rreth 28 °C, në zonat e brendshme dhe malore 26 °C, dhe në rajonet më të larta malore 23 °C. Temperatura ndryshon pak nga stina në stinë.

Elementi kryesor i ndryshueshëm i klimës së Indonezisë nuk është temperatura ose presioni i ajrit, por të madhe në rajon dhe klasifikohet si një vend i sapo-industrializuar. Sipas një vlerësimi të vitit 2022, ekonomia e Indozisë është e 17-të më e madhe në botë për nga PBB-ja nominale, dhe e 7-ta për sa i përket prodhimit të brendshëm bruto (PBB) bazuar në barazinë e fuqisë blerëse.

Indonezia ka burime të bollshme natyrore. Industritë e saj kryesore janë peshkimi, nafta, druri, produktet e letrës, rrobat e pambukut, turizmi, minierat e naftës, gazi natyror, boksiti, qymyri dhe kallaji. Produktet e saj kryesore bujqësore janë orizi, kokosi, soja, bananet, kafeja, çaji, palma, goma dhe kallam sheqeri. Këto mallra përbëjnë një pjesë të madhe të eksporteve të vendit, ku vaji i palmës dhe briketat e qymyrit janë mallrat kryesore të eksportit. Përveç naftës së rafinuar dhe të papërpunuar, edhe telefonat, pjesët e automjeteve dhe gruri, mbulojnë pjesën më të madhe të importeve shtesë. Kina, Shtetet e Bashkuara, Japonia, Singapori, India, Malajzia, Koreja e Jugut dhe Tajlanda, janë tregjet kryesore të eksportit të Indonezisë dhe partnerët kryesorë të importit.

GJUHA

Indonezishtja është gjuha zyrtare dhe kombëtare e Indonezisë, dhe arsimi, pothuajse të gjitha mediat kombëtare, qeverisja, administrata, gjyqësori, dhe forma të tjera të komunikimit atje, kryhen në indonezisht.

Indonezia është kombi i katërt më i populluar në botë, ku shumica flasin indonezisht, gjë që e bën këtë gjuhë mes gjuhëve më të folura në botë.

Shumica e indonezianëve, përveç gjuhës kombëtare, flasin gjithashtu rrjedhshëm të paktën një nga më shumë se 700 gjuhët lokale indigjene, të cilat përdoren zakonisht në shtëpi dhe brenda komunitetit lokal.

Anglishtja është gjuha e huaj më e njohur në vend. Përveç anglishtes, gjuhë të tjera të huaja të njohura në Indonezi janë arabishtja, japonishtja, koreanishtja dhe mandarin. Arabishtja mësohet për arsye fetare, pasi pothuajse 90% e popullsisë indoneziane janë myslimanë.

Feja

Indonezia është vendi me numrin më të madh të popullsisë muslimane në botë. Sipas regjistrimit të vitit 2010, më shumë se 87% e indonezianëve u deklaruan si myslimanë... pastaj, 9.87% të krishterë, 1.69% hindu, 0.72% budistë dhe pjesa e mbetur, si praktikues të besimeve të tjera.

Kushtetuta indoneziane siguron liri fetare, edhe pse qeveria zyrtarisht njeh vetëm: Islamin, Protestantizmin, Katolicizmin Romak, Budizmin, Hinduizmin dhe Konfucianizmin.

HISTORI

Kërkimet arkeologjike sugjerojnë se arkipelagu indonezian ka qenë i banuar të paktën 1.5 milion vite më parë.

Austronezianët, të cilët përbëjnë shumicën e popullsisë moderne të Indonezisë, mendohet se e kanë origjinën nga Tajvani, dhe kanë mbërritur në Indonezi rreth vitit 2000 p.e.s. Nga shekulli i 7-të i erës sonë, lulëzoi mbretëria e fuqishme detare Srivixhaja, e cila mbërriti deri në rajonin ku sot është Indonezia, duke sjellë me vete

atje ndikimet hindu dhe budiste. Më pas atje lulëzuan dinastitë budiste Sailendra dhe Hindu Mataram. Mbretëria e fundit e rëndësishme jomuslimane, mbretëria hindu Maxhapahit, lulëzoi nga fundi i shekullit të 13-të, dhe ndikimi i saj u shtri në pjesën më të madhe të Indonezisë.

Dëshmia më e hershme e popullsive të islamizuara në Indonezi daton që nga shekulli i 13-të, në Sumatrën veriore. Zonat e tjera indoneziane adoptuan gradualisht Islamin, i cili nga fundi i shekullit të 13-të deri në shekullin e 16-të, u bë feja dominuese në Xhava dhe Sumatra.

Nga shekulli i 16-të, në Indonezi mbërritën portugezët, të cilët kërkuan të monopolizonin burimet e arrëmyshkut të vlefshëm, karafilit dhe piperit indonezian. Në vitin 1602, holandezët themeluan në Indonezi Kompaninë Hollandeze të Indisë Lindore (VOC), e cila u bë fuqia dominuese evropiane deri në vitin 1610. Pas falimentimit, kjo kompani (VOC) u shpërbë zyrtarisht në vitin 1800, dhe qeveria e Holandës themeloi Inditë Lindore Hollandeze, dhe mbaheshin nën kontrollin e qeverisë. Nga fillimi i shekullit të 20-të, dominimi holandez u shtri në atë rajon, deri në kufijtë aktualë të Indonezisë. Pushtimi japonez dhe pushtimi i mëvonshëm në 1942-1945, gjatë Luftës së Dytë Botërore, i dha fund sundimit holandez në Indonezi dhe inkurajoi lëvizjen për pavarësi, lëvizje e cila ishte shtypur më parë. Dy ditë pas dorëzimit të Japonisë, në Gusht të vitit 1945, udhëheqësi nacionalist Sukarno shpalli pavarësinë e vendit dhe u bë president. Holanda u përpoq të rivendoste sundimin e saj, por pas një lufte të ashpër të armatosur, edhe diplomatike, edhe përballë presionit ndërkombëtar, holandezët e njohën zyrtarisht pavarësinë e Indonezisë në Dhjetor të vitit 1949.

SI ERDHI ISLAMI NË INDONEZI

Ardhja e Islamit në arkipelag mund të ndahet në tri faza: faza e parë që shtrihet nga Hixhreti (viti 622) e deri në vitin 1100; faza e dytë mbulon periudhën mes viteve 1100-1500, dhe faza e tretë shtrihet nga viti 1500 e deri në kohët moderne.

Faza e parë ishte produkt i kontakteve tregtare midis rajoneve detare të Oqeanit Indian. Tregtarë nga Jemeni dhe Gjiri Persik erdhën deri në brigjet e Malabarit, dhe prej andej në ishujt e Sri Lankës, Xhavas dhe Sumatras. Abasidët e fuqishëm në Bagdad e inkurajonin tregtinë globale. Në perëndim, karvanët e tregtarëve muslimanë e përshkuan Saharanë, përmes Afrikës Perëndimore, e depërtuan deri thellë, atje ku sot është Gana dhe Nigeria. Në lindje, Rruga e Mëndafshit për në Kinë ziente nga aktiviteti tregtar. Edhe tregtia me anë të detit nuk kishte mbetur prapa... Tregtarët muslimanë, ata arabë edhe persianë, lundruan në Oqeanin Indian dhe kapën pjesën më të madhe të tregtisë me Indinë, Afrikën Lindore, Indonezinë dhe Kinën. Kolonitë e tregtarëve muslimanë në Guxhrat, Malabar, Sri Lanka, Sumatra, Kanton dhe përgjatë gjithë bregdetit të Afrikës Lindore, u rritën ndjeshëm. El-Mes'udi shënon se në vitin 877, gjatë sundimit të perandorit Tang Hi-Tsung, në Kanton të Kinës gjendej një koloni prej gati 200,000 muslimanësh. Një rebelim fshatar në vitin 887, i detyroi këta muslimanë të iknin dhe të vendoseshin në Kheda, në bregun perëndimor të Malajas. Mes viteve 750 – 1100, kolonitë tregtare përgjatë brigjeve së Oqeanit Indian u rritën për nga madhësia edhe prosperiteti.

Të impresionuar nga ndershmëria dhe integriteti i tregtarëve muslimanë, një numër i madh malajësh pranuan Islamin. Martesat e përziera luajtën gjithashtu një rol të rëndësishëm në pranimin e Islamit nga banorët vendas, siç ndodhi në Malabar dhe Sumatra. Këta

muslimanë nuk ua imponuan zakonet dhe kulturën e tyre popullsisë vendase. Në vend të kësaj, ata u përshtatën me kulturën lokale, duke u prezantuar atyre në të njëjtën kohë Besimin në Një Zot të vetëm dhe kërkesat e Sheriatit. Arabët ishin gjithmonë një pakicë e vogël në mesin e malajëve, por gëzonin një pozitë të privilegjuar në shoqëri. Ata flisnin gjuhën e Kuranit dhe kishin reputacion për besim të fortë në Zotin dhe qëndrueshmërinë shpirtërore. Ata shikoheshin si bashkëshortë idealë, saqë edhe princat dhe sulltanët malajë e konsideronin nder të kishin brenda familjes një lidhje martesore me arabët. Ata me gjak arab nderoheshin si Sejidë - Zotërinj, si pasardhës të familjes së Profetit – paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!

Kjo periudhë shënoi zenitin e qytetërimit klasik Islam. Gjatë shekujve të 8-të dhe të 9-të, u zhvilluan shkollat kryesore të Fikhut në Medine dhe Kufe. Islami që mbartej nga tregtarët arabë dhe persianë për në rajonin e Indonezisë, kishte një përmbajtje të madhe të Sheriatit dhe Fikhut. Islami i hershëm në Indonezi dhe Malajzi pasqyronte rrymat intelektuale në Azinë Perëndimore, megjithëse ky rajon ishte jashtë rrethit politik ushtarak të Perandorisë Abbaside. Një rol të rëndësishëm në këto zhvillime luajti institucioni i Haxhit. Shumica e arabëve ndoqën shkollat e mendimit Shafi dhe Maliki, të cilat ishin shkollat dominuese në Medine dhe Damask, dhe rrjedhimisht, këto shkolla të fikhut u sollën nga haxhijtë edhe në Indonezi dhe Malajzi.

Gjatë periudhës mes viteve 1100 – 1500, Islami u përhap gjerësisht në Indonezi dhe Malaja. Përhapja e Islamit në arkipelag ndoqi një përparim gjeografik, gjatë një periudhe 400 vjeçare (1100-1500), duke filluar me Sumatrën, e ndjekur nga Xhava, Malaja, Borneo, Sulu (Mindanao), Sulawesi dhe Luzon (Manila). Shejhu Abdullah Arifi, një dijetar nga Arabia, e futi Islamin në Sumatra rreth vitit 1100. Një nga nxënësit e tij, Shejh Burhan Shah, e vazhdoi veprimtarinë e Thirrjes Islame në të gjithë Sumatrën veriore. Sundimtari i parë i Sumatrës veriore që pranoi Islamin ishte Johan Shah (1204), por vetëm gjatë sundimit të Sulltan Malik Es-Saalih (vd. 1297) Islami mori një hov të madh.

Qyteti Pasai u bë një qendër islame e arsimit. Ibn Batuta e vizitoi Pasain në vitin 1345, dhe e gjeti sundimtarin e tij, Sulltan Malik Ez-Zaahir, si një njeri të devotshëm, një mbrojtës të dijetarëve dhe një përhapës entuziast të besimit Islam. Sulltani Malik Ez-Zaahir ishte nipi i sulltanit Malik Es-Saalih. Në vitin 1396, Parameswara, një princ nga Xhava, u arratis në Malaka. Ai pranoi Islamin dhe u martua me një vajzë të Sulltanit të Pasait, pastaj e ndryshoi emrin e tij në Sulltan Iskander Shah (1406). Ky princ ishte ai që e futi Islamin në Malaja.

Në shekujt 14 dhe 15, Xhava ishte selia e mbretërisë së fuqishme hindu Maxhapahit, me qendër në qytetin modern të Xhakartës. Bujqësia dhe tregtia e erëzave ishin shtyllat kryesore të kësaj mbretërie. Mbretëria Maxhapahit dominonte ishullin Xhava dhe tregtinë atje. Raxhat (prijësat) më të vegjël dhe krerët lokalë që kontrollonin portet lokale, i paguanin haraç sundimtarit Maxhapahit. Ndërsa tregtia midis Arkipelagut dhe botës myslimane u rrit, shumë nga këta raxha dhe prijës vendas e panë më të dobishme të krijonin lidhje më të ngushta me Indinë muslimane dhe Azinë Perëndimore sesa me oborrin Maxhapahit. Një nga një, raxhat dhe krerët vendas pranuan Islamin. Konvertimi solli me vete ndjenjën e përkatësisë në një vëllazëri më të madhe ndërkombëtare, si dhe avantazhe të rëndësishme në tregti. Në kohën e duhur, vetë oborri mbretëror Maxhapahit ra nën ndikimin islam, saqë në vitin 1450, Islami u bë feja dominuese e oborrit.

Në vitin 1451, Shejh Rahmat, një i burrë i ditur që vepronte pranë qytetit modern Surabaja, e konvertoi në Islam sundimtarin Maxhapahit, Raxha Kertawixhaja. Nga viti 1475, mbretëria Maxhapahit e ndryshoi karakterin e saj dhe u kthye në një sulltanat musliman.

Për një periudhë afërsisht katërqind vjeçare, Islami u përhap si një fener, i bartur nga ishulli në ishull.... Sa herë që banorët e një ishulli pranonin Islamin, ata vetë bëheshin flamurtarët e besimit të ri dhe punonin shumë për ta përhapur atë më tej. Në kohën kur portugezët dhe spanjollët arritën në skenë, në shekullin e 16-të (1512 e tutje), i gjithë Arkipelagu ishte ose nën ndikimin e Islamit ose në rrugën e tij për t'u bërë mysliman.

***

Në fazën e tretë, vitet 1500 – 1950, vazhdoi konsolidimi i Islamit që kishte filluar në fazën e dytë. U bënë hapa të mëdhenj jo vetëm në përhapjen e Islamit ndër njerëz, por edhe në evoluimin e kulturës dhe letërsisë. Ndikimi i Islamit në gjuhën malaje ishte i thellë. Në Indi dhe Pakistan, ndikimi kulturor i turqve muslimanë kishte rezultuar në lindjen e një gjuhe të re, Urdu. Kurse në Indonezi dhe Malajzi, ndikimi fetar i dijetarëve muslimanë e transformoi gjuhën malaje.

Popujt malajë të Indonezisë dhe Malajzisë, gjetën në besimin e ri një burim bashkimi kombëtar dhe solidariteti botëror.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://en.wikipedia.org
https://www.britannica.com
https://www.marefa.org
https://jembatanbahasa.com
https://historyofislam.com
https://www.worldometers.info

SI E PRANOI ISLAMIN DHE ÇFARË LIDHJE KA AJETI I SURES EL-HAXH ME ISLAMIZIMIN E TIJ?

Njihu, se si e përqafoi Islamin politikani holandez Joram van Klaveren, pasi që e luftoi atë për vite të tëra, në një dialog me TRT:

Nga ekstremi i djathtë në përqafimin e Islamit!

PYETJE PËRGJIGJE ME POLITIKANIN HOLANDEZ MUSLIMAN, KLAVEREN

- "Po shkruaja një libër kundër Islamit, ku po kërkoja përgjigje për pyetjet e mia.

Ndërkohë, që po lëvizja librat e mi, disa më ranë nga rafti dhe në mesin e tyre ishte edhe Kur'ani. Kur e mora në dorë, gishti im ishte vendosur tek ajeti 46 i sures El-Haxh, ku thoshte: "Me të vërtetë nuk verbohen sytë, por verbohen zemrat, të cilat janë në kraharor!

Pasi u zgjova ditën e tjetër, ndjenjat e mira të trazuara ishin qetësuar plotësisht. Ndjeva forcë e lumturi në zemër dhe në atë ditë, e njoftova gruan dhe nënën time, se jam bërë musliman!"

- CILI ËSHTË MENDIMI YT PËR MARRËDHËNIET E PERËNDIMIT ME TURQINË?

"Evropa është e tejskajshme, kur vjen puna te çështja e Turqisë. Bërthama e Bashkimit Evropian sot është shumë kundër Zotit. Kjo luan një rol të madh në qëndrimin e shumë politikanëve këtu.

Sikur të isha turk, personalisht nuk do ta kisha dëshiruar të bëhesha anëtar i Bashkimit Evropian për shkak të qëndrimit të tyre".

- CILI ËSHTË MENDIMI YT PËR ISLAMOFOBINË DHE FJALIMET EKSTREMISTE?

"Ka mungesë njohjeje... Kjo gjë luan në rol kryesor. Në Perëndim, shumica e njerëzve nuk dinë shumë për Islamin.

Mjetet e informacionit dhe globalizmi ekstrem luajnë gjithashtu një rol të madh".

- SI JE BALLAFAQUAR ME ZEMËRIMIN E RRETHIT TËND, PASI KE DEKLARUAR ISLAMIN?

"Ka pasur kërcënime me vrasje. Disa njerëz kanë dashur të vrasin fëmijët e mi dhe të dhunojnë gruan time, në një formë ekstreme.

Por, natyrisht, në atë mënyrë që ka qenë gabimi im. E kam përhapur ekstremizmin në të kaluarën dhe u përballa me këtë ekstremizëm prej shokëve të mi të vjetër.

Kështu është jeta, natyrisht, çfarë bën do ta pësosh.

Por, falënderimi i takon Allahut, pas kësaj situata u bë e lehtë".

- SI KE QENË PËRPARA ISLAMIT?

"Për vite të tëra, si politikan, kam dhënë gjithë maksimumin tim, për ta luftuar Islamin. Jam përpjekur të kaloj (miratoj) projekte për mbylljen e të gjitha shkollave islame dhe xhamive në Holandë. Jam përpjekur të ndaloj tërësisht Kur'anin. Kam qenë plotësisht i bindur, se Islami është dhunë, kundër femrës, armik i krishterimit dhe përhapës i terrorizmit".

(Marrë nga TRT Arabij)

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

Bekuar qoftë ai

që më ka mbërritur

dhe më ka besuar!

Bekuar qoftë ai

që nuk më

ka mbërritur

dhe më ka besuar!

(Transmetuar nga Ibn Nexhari dhe Tabaraniu)

"RROBA E DEVOTSHMËRISË ËSHTË MË E MIRË!"

Pasdreken e së mërkurës, më 1 shkurt 2023, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet me rastin e Ditës Botërore të Hixhabit, me temë: "Rroba e devotshmërisë është më e mirë".

Në këtë aktivitet merrnin pjesë teologe, mësuese, intelektuale, studente, nxënëse dhe besimtare. Ai u zhvillua në një format ndryshe nga takimet e tjera, në një formë bashkëbisedimi miqësor dhe shkëmbimi idesh e përvojash mes motrave myslimane.

Nën moderimin e teologes Zamira Bushati, ky takim trajtoi disa tematika, si:

– "Hixhabi në këndvështrimin Islam", nga teologe Jetmira Kakini.

– "Hixhabi në aspektin social, dhe në karrierë", nga punonjësja sociale në karrierë, znj. Arjeta Pelinku.

– "Hixhabi si shenjë dinjiteti dhe integriteti", nga teologe Ferzet Ndoja.

– Diskutim rreth disa pyetjeve, ku moderatoreja ia drejtoi pjesëmarrëseve, të cilat dhanë idetë dhe shkëmbyen përjetimet dhe eksperiencat e tyre në lidhje me hixhabin.

– Në fund të këtij bashkëbisedimi, u rrëfye një histori personale motivuese hixhabi, nga jeta e studentes Jesmina Ajazaj, e cila ka vendosur të mbart shaminë para disa muajve.

KËSHILLIME DHE DISKUTIME RRETH VAKËFEVE TË FSHATIT BARBULLUSH

Paraditën e së enjtes, më 2 shkurt 2023, në kuadër të analizës së gjerë të vakëfeve, problematikave, ideve të zhvillimit dhe angazhimit për gjallërimin e tyre, në ambientet e Myftinisë Shkodër, u diskutua rreth vakëfeve të fshatit Barbullush.

Myftiu dëgjoi nga administratori dhe menaxheri i vakëfeve disa nga problematikat e trashëguara ndër vite, bashkëpunimin me ish-Komunën Bushat dhe Bashkinë e Vaut të Dejës aktualisht për kapërcimin e disa problematikave, por që për fat të keq kanë ngelur peng i burokracive të pakuptimta të institucioneve tona.

Myftiu dëgjoi edhe imamin e xhamisë së fshatit Barbullush, i cili shprehu ankesat e besimtarëve, sidomos për vakëfin e varrezave, që akoma nuk

ka marrë drejtimin e duhur dhe që ka përpjekje për zaptimin e tij, pavarësisht dëshmive dhe letrave që dëshmojnë për origjinën e këtij vakëfi.

U diskutua edhe për zhvillimin e krejt zonës së vakëfit brenda rrethimit të xhamisë, ku disa projekte të vlefshme presin prej kohësh mbështetjen e duhur dhe zbatimin konkret.

U la porosi që të ndiqen me prioritet udhëzimet e këtij takimi si dhe të zhvillohet një takim në Bashkinë e Vaut të Dejës, për zgjidhjen e çëahtjes së varrezës muslimane të fshatit Barbullush.

NJË NATË E PAHARRUESHME NË ST. GALLEN, NË "EL-HIDAJE" TË VLERAVE TË BESIMIT

Më 11 shkurt 2023, e shtunë, Bashkësia Islame "El-Hidaje" në St. Gallen, organizoi tribunën fetare kuashtuar iniciativës për ndërtimin e xhamisë së re në qytet.

Në këtë mbrëmje morën pjesë përfaqësues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Turqia, Kroacia, imamë, kryetarë, anëtarë e përfaqësues të xhamive në Zvicër dhe xhematë të shumtë.

Kjo tribunë, përpos që kishte karakter fetar, ishte edhe informative, me ç'rast u shpalosën rezultatet e derimëtanishme në lidhje me zhvillimet për ndërtimin e xhamisë së re në qytet. Xhemati dhe mysafirët u informuan për blerjen e parcelës, konkursin e projekteve ideore për xhaminë e re, si dhe u bë shpallja e projektit fitues.

Të pranishmit i përshëndeti dhe iu dëshiroi mirëseardhje, imami i xhamisë, Mehas ef. Alija dhe kryetari i saj, Sadush Ajrullai, i cili i njohu për rrjedhat e inciativës për xhaminë e re.

Fjalë rasti patën kryetari i DIGO-s, Yakup Gürgun, drejtori për diasporën pranë Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, si dhe myftiu i Shkodrës, Muhamed ef. Sytari.

Për pjesët artistike, kuranore dhe të ilahive, u kujdesën Hafiz Aziz Alili dhe imami i xhamisë së "Aja Sofijes" në Stamboll, hfz. Bynjamin Topçuoglu, si dhe hoxha nga Kumanova, Ismet ef. Selimi. Gjithashtu, të pranishmit patën mundësi të ndjekin edhe një program të shkurtër artistik nga nxënësit e Mektebit të xhamisë El-Hidaje.

Një kontribut të vyeshëm dhanë edhe hoxhallarë dhe kryesi të xhamive përreth, të shoqëruar edhe me xhematlinjë të tjerë, sidomos kontribut të veçantë dhanë imamët dhe kryetarët e xhamive të Wilit, Sulgenit, Frauenfeldit, Glarusit, Reinachut dhe Grenchenit, të cilët ishin edhe pjesë e panelit të diskutimit.

Befasi e bukur e kësaj tribune ishte edhe pranimi i Islamit, përpara një mase të madhe njerëzish, nga dy të rinj të lindur dhe të rritur në Zvicër.

Pjesa e fundit e programit iu kushtua tubimit të mjeteve financiare për xhaminë e re, me ç'rast u tubuan rreth 300'000 CHF.

Gjatë pauzës pjesëmarrësit patën mundësi që të shijojnë edhe disa gjëra ushqimore dhe ëmbëlsira tradicionale të përgatitur nga kryesia dhe xhemati i xhamisë El-Hidaje.

Në fund, imami i xhamisë dhe moderatorja, znj. Behare Mustafi, falënderuan mysafirët e programit, pjesëmarrësit, xhematin, aktivistët, sponsorët, donatorët, kryesinë e xhamisë, si dhe të gjithë të tjerët që ndihmuan dhe dhanë kontributin e tyre që mbrëmja të shkojë sipas agjendës së planifikuar.

(marrë nga profili i xhamisë 'Xhamia El-Hidaje', në facebook)

NË SHKODËR PËRKUJTOHET ISRAJA DHE MIRAXHI

Dita e xhuma, më 17 shkurt 2023, përkoi me natën e 27 të muajit Rexheb 1444, ku 15 shekuj më përpara ka ndodhur mrekullia e madhe e Pejgamberit (a.s), Israja dhe Miraxhi.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, dha një mesazh për besimtarët, duke theksuar, se: "Israja dhe Miraxhi erdhën si përforcim i Hz. Muhammedit (a.s) në rrugën e tij të mundimshme të Thirrjes, në edukimin e brezave me dritën e udhëzimit hyjnor dhe begatitë e fesë së Allahut; ISLAMIT!

A nuk është e udhës, që teksa lexojmë për takimin e Resulull-llahut (a.s.) me pejgamberët më të zgjedhur të historisë dhe racës njerëzore, të mësojmë të lexojmë rolin e mrekullueshëm që ka muslimani në jetë, për të ftuar drejt harmonisë në mesin e popujve, besimeve, etniteteve, kulturave dhe për të dhënë shembullin e tij elitar në hartën e madhe të diversitetit, ku 'më fisniku tek All-llahu, është më i ruajturi!'?"

Në përkujtim të kësaj ngjarjeje madhore, të udhëtimit natën (Israsë) dhe të ngritjes në qiell (Miraxhit), për mësimet dhe mesazhet, që mbart, hytbeja e xhumasë së kësaj jave, në xhamitë e Shkodrës iu kushtua kësaj mrekullie të jashtëzakonshme.

Gjithashtu, në përkujtim të kësaj Nate të Madhe, u zhvillua edhe një bashkëbisedim në Tv1 Channel, me teologun Lavdrim Hamja, në emisionin "Start" të gazetares Linda Doda (Kavaja).

Përmes këtij bashkëbisedimi, imam Hamja hodhi dritë mbi këtë ngjarje të jashtëzakonshme të mbushur plot me mesazhe dhe mësime, duke shpjeguar fillimisht, se çfarë është mrekullia në Islam, çfarë vlere kanë ato, si kanë ndodhur, etj.

Ndër të tjera ai tha, se Nata e Israsë dhe Miraxhit ka një rëndësi të madhe për muslimanët, sepse kjo ngjarje tregon për vendin e lartë që ka xhamia Aksa, rëndësia e të besuarit te të gjithë Profetët e Zotit, pa dallim mes tyre, ruajta dhe mbrojtja e natyrës së pastër të njeriut nga devijimet e ndryshme, si dhe veçanërisht namazi ose falja e pesë kohëve në ditë, pasi në këtë Natë të Madhe, direkt në këtë udhëtim qiellor, Pejgamberit (a.s) iu dha si dhuratë, detyra e pesë namazeve ditore.

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"A doni t'ju tregoj se me çfarë i fshin Allahu gabimet dhe i lartëson gradët"? Thanë: Po, si jo, o i Dërguar i Allahut! Tha: "Marrja abdes mirë kur përton dhe hapat e shpeshtë për në xhami; pritja e namazit pas namazit. Kjo është lidhja e fortë!".

(Transmetuar nga Muslimi)

MEJTEPI IM... XHAMIA DRAGOÇ

Pak histori:

- Xhamia Dragoç, ndodhet në Njësinë Administrative Postribë, Shkodër.

- Aktualisht, përbëhet prej rreth 500 familjeve myslimane.

- Familjet më të vjetra janë: Çelaj, Halilaj, Hasaj, etj.

- Në vitin 1990 besimtarët myslimanë rimorën xhaminë pasi në kohë të regjimit barbar monist objekti ishte kthyer në vatër kulturore komuniste. Në vitin 1994, ajo u prish krejtësisht, gurët e ndonjë mjet tjetër ndërtimor u morën për ndërtimin e xhamisë së re, e cila përfundoi në vitin 2004 me ndihmën e banorëve të fshatit, të emigrantëve dhe kontributin e bamirësve nga Emiratet e Bashkuara Arabe, me ndërmjetësimin e hoxhës tonë të madh, H. Vehbi S. Gavoçi!

- Imamët e xhamisë Dragoç, njëkohësisht edhe mësues të mejtepeve që kanë shërbyer gjatë këtyre viteve dhe në vazhdim janë: Resmi Lika, Agim Hoxha, Ilmi Halili dhe imami aktual, Shkëlqim Sykaj.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 20 mejtepe dhe kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002-2023 është rreth 600 nxënës.

Takimi me nxënësit:

Në vijim të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi më 17 shkurt 2023 një takim në një nga klasat e mejtepit fetarë/qendrës kulturore në Dragoç.

Drejtuesi i arsimit, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit Fuqiplotë.

Teologu Halluni falënderoi mësuesin e mejtepit dhe njëherit edhe përgjegjës i qendrës, Shkëlqim Sykaj si dhe mësuesit e tjerë bashkëpunues, të cilët me përkushtim angazhohen në edukimin e brezit të ri më mësimet e vërteta islame dhe sipas traditës fetare dhe kombëtare.



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek